



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/233 Nr. i faq/Br.str/No.pg 66

Data/Datën/Date 30.05.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 253 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2009"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor)

1. Me këtë vendim miratohet kërkesa e qytetarëve të fshatit Zoqishtë për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelat publike kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510032-00069-0 në zonën kadastrale Zoqishtë, në vendin e quajtur gramada shkola, në posedim të P.SHE KOSOV. K.K. RAHOVEC – SHFRY. SHKOLLA FILLORE BORO DHE RAMIZI, në sipërfaqe të përgjithshme prej 8082m² (tetëmijë e tetëdhjetë e dy metra katrorë) nga e cila ndahet sipërfaqja prej 462m² (katërqind e gjashtëdhjetë e dy metra katrorë).
2. E drejta e kalimit në pjesën e parcelës kadastrale të cekura në nenin 1 të këtij vendimi ka gjerësinë 5 (katër) metra dhe në gjatësinë e përgjithshme prej 94.98 (nëntëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e tetë) metra.
3. Krijimi i të drejtës së kalimit në pjesët e parcelave kadastrale të cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi i dedikohet banorëve të Lagjes 85 në Zoqishtë, të cilët janë posedues të pronave private, e të cilët nuk kanë qasje në rrugën publike dhe si bartës të të drejtës së kalimit sipas këtij vendimi do të kenë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit, respektivisht rrugës si e mirë publike, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese të tokës komunale, me kusht që ndërtimin dhe meremetimin e kësaj rruge ta kryejnë me shpenzimet e veta.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e pronës në librat kadastral.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.233/24
Me datë:30.05.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

